

**Partneriteti strategjik ndërmjet Turqisë dhe Bashkimit Evropian:  
Menaxhimi i krizës së migrimit ilegal nga vatrat e luftës në rajonin e Lindjes së  
mesme**

**TEMA PËR TITULLIN MASTER NË  
DREJTIMIN INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE  
NGA  
BESIM IMERI**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE**

Janar, 2022

## **Rezyme e temës**

### **Partneriteti strategjik ndërmjet Turqisë dhe Bashkimit Evropian: Menaxhimi i krizës së migrimit ilegal nga vatrat e luftës në rajonin e Lindjes së**

**Mesme**

**Nga**

**Besim Imeri**

**Mentori: Pro. Ass. Dr. Bardhok Bashota**

Qëllimi i punimit është të tregojë historikun e zhvillimit të bashkëpunimit BE – Turqi, sfidat me të cilat është karakterizuar bashkëpunimi midis palëve, ndikimi që e ka pas kriza e refugjatëve në bashkëpunimin midis BE –së dhe Turqisë dhe ndikimi i pandemisë Covid 19 në ofrimin e palëve pas situatave të pafavorshme politike të cilat i kanë parapri tensioneve midis palëve deri tash.

### **PËRMBLEDHJE**

Turqia gjithmonë i ka kushtuar rendësi të madhe bashkëpunimit me vendet e Evropës. Prej shpallës së turqisë Republikë nga babai themeltar i Turqisë moderne Kemal Ataturk në vitin 1923, ajo zgjodhi modelin e Evropës Perëndimore për ndertimin e strukture së saj laike. Turqia bëri një kthesë historike në ofrimin me perëndimin duke ndërmarrë edhe hapa konkretë si: anëtarësimi në OKB, NATO, OECD dhe Këshillin e Evropës. Turqia edhe gjatë luftës së ftohtë luajti rol të rëndësishëm duke mbrojtur vlerat fundamentale mbi të cilat ishte ngritur edhe bashkëpunimi midis vendeve anëtarë të Komunitetit Ekonomik Evropian si: liria, demokracia dhe të drejtat e njeriut. Prandaj, gjithë ky bashkëpunim politik i parapriu një bashkëpunimi në fushën ekonomike. Hapat konkretë në këtë drejtim u ndërmorrën në vitin 1959 kur turqia zgjodhi të bashkëpunojë më Komunitetin Ekonomik Evropian.

Mirëpo, rruga e turqisë drejtë anëtarësimit nuk kaloi nëpër ditët më të mira. Situatat politike të brendshme e pamundësuan një progres real drejtë anëtarësimit. Puçet e shpeshta ushtarake,

qështja e qipros, mungesa e zhvillimit të demokracisë dhe respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut ishin disa nga sfidat të cilat e pengonin rrugën e anëtarësimit.

Pavarësisht situatave të karakterizuara me regres në zbatimin e reformave bashkëpunimi midis turqisë dhe BE – së ishte i pakontestueshëm. Krizat globale si ajo e refugjateve që vinin nga Lindja e Mesme pas konflikteve civile e bëri të detyrueshëm një bashkëpunim midis palëve me qëllim të menaxhimit sa ma të mirë të një numri rekord të refugjatëve që kishin shkelur tokën e Bashkimit Evropian. Turqia u pa si mundësia më e mirë për të arritur suksesin e nevojshëm për shkak të pozitës së saj gjeografike sepse ishte vend tranzit për mijëra migrantë që destinacion kishin vendet anëtarë të BE – së. Kriza me migracionin ilegal erdhi në kohën kur tensionet midis palëve ishin të medha. Në këtë kohë diskutohej shpesh edhe pezullimi i komplet negociatave të anëtarësimit të Turqisë. Prandaj, për promotorët e një bashkëpunimi BE – Turqi kriza erdhi në momentin e duhur si mundësi reale për rifillimin e negociatave. BE – ja i premtoi turqisë shpejtimin e negociatave të anëtarësimit dhe liberalizimin e vizave për qytetarët turq si dhe nga pala turke kërkohesh reformimi i Unionit Doganor. Marrëveshja e nënshkrua në vitin 2016, duke kthyer miliona refugjatë nga vendet anëtare të BE – së në Turqi.

Marrëveshja tregoi efektet e saj duke ulur numrin e migraenteve ilegal dhe duke e rikthyer kontrollin e kufijve të BE – së që deri tani ishin jashtë qdo kontrolli. Mirëpo, zgjatja e konflikteve në vendet prejardhëse të migraenteve e bënë të pamundur që në një periudhë të shkurtë qështja me refugjatët të zgjidhet.

Në kohën kur kishte përafrime në bashkëpunimin BE – Turqi, qështjet e brendshme në turqi pas pucit ushtarak i kthyen tensionet midis paleve. Rrethanat e brendshme politike në Turqi të krijuara prej vitit 2016 e tutje quan në akuza dhe kritika nga ana e BE – së në drejtim të Turqisë për shkelje të të drejtave të njeriut dhe deficite në sundimin e ligjit. Sulme pati edhe nga ana e Turqisë e cila ndjeku një retorikë kundërshtuese për Evropën duke e akuzuar për mos përmbushjen e marrëveshjes për migrantët dhe përdorimin e standardeve të dyfishta në rrugën e anëtarësimit.

Edhe sot, turqia është jashtë BE – së dhe pa liberalizim të vizave pavarësisht angazhimit të saj në menaxhimin e refugjatëve.

## **PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E KAPITUJVE**

Ky punim përbëhet prej katër kapitujve. Kapitulli i parë, përfshinë një historik të marrëdhënieve midis BE – së dhe Turqisë, fazat nëpër të cilat ka kaluar Turqia më synimin kryesor anëtarësimin në BE. Këtu përfshihet rendësia gjeografike e turqisë si element përcaktues i partneritetit Turqi – BE. Pastaj, etapat pozitive dhe negative të cilat i kanë karakterizuar marrëdhëniet BE – Turqi deri në vitin 2005 kur edhe u hapën negociatat e anëtarësimit për Turqinë si: Marrëveshja e Ankarasë, regjimi ushtarak turk i vitit 1980, krijimi i Unionit Doganor dhe Partneriteti i Anëtarësimit.

Kapitulli i dytë, përfshinë periudhën pas vitit 2004 deri në vitin 2015, periudhë e cila u karakterizua më një stadë negativ të marrëdhënieve për shkak të ngecjeve në realizimin e reformave të brendshme. Menjëherë pasi u hapën negociatat e anëtarësimit për turqinë në vitin 2005, qeveria turke e udhëhequr nga Partia për Drejtësi dhe Zhvillim shkoi drejtë një demokracie të centralizuar, e cila u karakterizua me kufizime mbi liritë themelore si liria e shprehjes, ngecjeve në reformat gjyqësore etj. Por, pavarësishtë sfidave të cilat e pengojnë një progres në krijimin e marrëdhënieve të shëndosha midis palëve dhe përparimit në procesin e anëtarësimit, egzistojnë disa fusha ku bashkëpunimi është i pashmangshëm. Bashkëpunimi ekonomik, lufta kundër terrozimit dhe migrimit janë tri fushat më rendësi strategjike të cilat e imponojnë një bashkëpunim dhe periudhat negative të kohë pas kohëshme i kthejnë në frymë bashkëpunimi dhe partneriteti dy palësh. Krejtë në fund, ky kapitull përfshinë ndikimin e pranverës arabe dhe implikimet e qështjes siriane në partneritetin midis Turqisë dhe BE – së.

Kapitulli i tretë, përfshinë partneritetin BE – Turqi në menaxhimin e krizës më migrimin ilegal. Krizat e vazhdueshme në Lindjen e Mesme e sidomos konflikti civil në Siri pati pasoja të mëdha edhe në kontinentin evropian. Migrimi masiv me të cilin u përballë BE – ja dhe pamundësia që e vetme të arrijë futjen në kontroll të një numri migrantësh ndër më të mëdhatë që ka parë ndonjëherë e shtynë BE – në të kërkojë partner më qëllim të menaxhimit më të lehtë të një fluksi të tillë migrantësh. Turqia ishte opsioni më i mirë dhe mundësia ideale për zgjidhje të kësaj shtate. Pra, kjo ishte qeshtja që e impononte një bashkëpunim midis palëve dhe të dyja u munduan që qeshtjen e migrantëve ta shfrytëzojnë më qëllim të arritjes së objektivave të veta. Në këmbim të një marrëveshje bashkëpunimi në këtë qështje, Turqisë i'u premtua liberalizimi i vizave dhe rifillimi i negociatave të pranimit të cilat deri në këtë kohë ishin karakterizuar me një pezullim nga ana e BE – së pas veprimeve nga turqia, ndërsa BE – ja në këmbim të një

marrëveshje me turqinë përfitonte në uljen e numrit të migrantëve, kthimin e kontrollit kufitar të BE – së dhe luftimin e terrorizmit. Ky kapitull përfshinë rolin që BE dhe Turqia kanë pasur në menaxhimin e krizës së migrantëve ilegal, ndihmën financiare që BE – ja ka dhënë për turqinë me qëllim të përballojë kostot financiare për miliona refugjatë që mbante në territorin turk dhe performancën e treguar nga të dyja palët në menaxhimin e migrantëve.

Në kapitullin e katërt: kapitulli i katërt dhe i fundit përfshinë sfidat më të cilat përballën palët, diskutet të cilat mbizotërojnë në të dy taborrët, percaktimi i marrëdhënieve nga perspektiva e BE – sw dhe turqisë dhe ndikimi i pandemisë Covid 19 në marrëdhëniet Turqi – BE.

## **Metodologjia**

Gjatë punës hulumtuese mbi temën janë përdorur një numër metodash cilësore të kërkimit dhe hulumtimit siç janë ato historike, shpjeguese dhe metoda e analizës së literaturës e cila analizon literaturë e gjitha ndërkombëtare, fjalime politike, deklaratat qeveritare dhe deklaratat të institucioneve përgjegjëse. Metoda e analizës historike në këtë studim analizon fazat nëpër të cilat ka kaluar një bashkëpunim i tillë midis BE – së dhe Turqisë dhe arsyt kryesore që i paraprinë një bashkëpunimi të tillë. Metoda shpjeguese përbën metodën kyçe të studimit. Me anë të metodës shpjeguese do të shpjegohet arsyt që quan në një orientim properëndimor nga Turqia, ndikimi i pozitës gjeografike të saj në trajtimin e vendit si partner gjeostrategjik nga BE – ja, ndikimin e krizës së migraenteve ilegal në konsolidimin e raporteve midis palëve dhe performancën e treguar nga të dyja palët në menaxhimin e kësaj krizë nder më të mëdhatë më të cilat është përballur BE – ja deri më sot. Ky punim është realizuar duke mbledhur të dhëna sekondare, janë bërë hulumtime të ndryshme, janë përdorur artikuj shkencor, burime elektronike nga më të ndryshmet vetëm që ky punim t'i plotësoj të gjitha normat e një shkrimi akademik dhe domethënës

Hulumtimi synon të japë përgjigje në pyetjet hulumtuese:

P.1. Pse Bashkimi Evropian e sheh Turqinë si të paiteruesuar që të anëtarësohet në BE dhe a egziston një bindje e tillë edhe në taborrin turk?

P.2. A ka bërë mjaftueshëm Turqia në plotësimin e kriterëve të anëtarësimit?

P.3. A janë arsyt kulturore pengesë që Turqia të lihet jashtë BE – së?

P.4. Kriza me refugjatet a e shfaq paaftësinë dhe joseriozitetin e BE –së si një partner strategjik bashkëpunues?

P.5. Cili ishte epilogu i bashkëpunimit BE – Turqi rreth qështjes së migrimit ilegal?

Si dhe hipotezat për të i vërtetuar;

H1 “Bashkimi Evropian nuk e sheh Turqinë si të interesuar që të bëhet pjesë e BE – së”

H2 “Turqia e sheh veten si të padëshiruar në mesin e familjes evropiane”

H3 “Pengesat kryesore të anëtarimit të Turqisë në BE janë arsye kulturore”

H4 “Kordinimi rreth krizës së refugjatëve nga BE dhe Turqia ishte jo– efektiv”